

Two thin black diagonal lines intersecting on the left side of the page, extending from the top-left towards the bottom-right and from the top-right towards the bottom-left.

sagemax

Udhëzimet e përdorimit

PMMA Disc
për teknologjinë CAD/CAM

Përshkrimi

"Sagemax PMMA Disc" është prodhuar për krijimin e restaurimeve të përkohshme përmes një teknologjie CAD/CAM.

Karakteristikat mekanike

- | | |
|----------------------------------|--------------------------|
| – Rezistenca në përkulje | ≥50 MPa |
| – Thithja e ujit sipas ISO 10477 | ≤40 µg /mm ³ |
| – Tretshmëria | ≤7,5 µg /mm ³ |

Përbërja

- Metakrilat polimetili (PMMA)
- Pigmente ngjyrash

Indikacionet

- "Sagemax PMMA Disc" është prodhuar për krijimin e protezave të përkohshme dentare.
- Rastet e përdorimit përfshijnë: Këllëf i përparmë dhe i pasmë, dhe ura me deri në 2 trupa për një periudhë maksimale mbajtjeje prej 6 muajsh.

Kundërindikacionet

- Reduktim i pamjaftueshëm i strukturës së dhëmbëve.
- Strukturë e pamjaftueshme për ngjitjen dhe shpërndarjen e duhur të forcave.
- Higjienë e pamjaftueshme orale.
- Hapësirë e pamjaftueshme e ndërmjetme për bashkimet e mjaftueshme në ura.
- Alergji të njohura. Mospërputhje të njohura ndaj përbërjes së produktit.
- Cementimi i përhershëm.

Parametrat e dizajnit

- Për këllëfët, mos shkoni poshtë trashësisë minimale të murit prej 1 mm.
- Kur projektini ura me një trup të lidhur, prerja tërthore e lidhjes mes këllëfit dhe njësisë së trupit nuk mund të jetë më pak se 12 mm².
- Kur projektini ura me një gamë prej deri në dy trupa të lidhur, prerjet tërthore të lidhjes mes këllëfit dhe trupave nuk mund të jenë më pak se 12 mm².

Lëmimi

Për shkurtimin dhe ndarjen e skeleteve, përdorni një frezë tërthore prej karbidi volframi ose disk ndarës të përshtatshëm për akrilikë.

Lustrimi

Restaurimet mund të lustrohen paraprakisht me një lustrues të përshtatshëm silikoni dhe një furçë të vogël me qime dhie. Agjentët standardë akrilikë të lustrimit janë gjithashtu të përshtatshëm për përdorim intraoral. Shmangni krijimin e nxehtësisë së tepërt. Lëmimi i kujdesshëm është absolutisht i nevojshëm për të arritur rezultate perfekte, për të shmangur akumulimin e kariesit dhe ndaj efekteve të tjera përkatëse negative për ngjyrën.

Pastrimi

Vendoseni restaurimin e përfunduar në një njësi me ultratinguj për rreth 1 minutë. Përmbajtja e solucionit të pastrimit alkalik duhet të jetë një maksimum prej 10% dhe një temperaturë maksimale prej 40°C. Shmangni pastrimin me avull dhe forcën ngjeshëse.

Vendosja

Pas përgatitjes së dhëmbit, përdorni skadat e nuancave për të krahasuar nuancën dhe për të konfirmuar nuancën e restaurimit. Vendosni restaurimin e përkohshëm me një cement të përkohshëm adeziv. Hiqni cementin e tepërt. Janë të përshtatshme të gjitha materialet e përkohshme të cementimit/adezive. Nëse restaurimi do të cementohet me ngjitje, duhet të përdoren materiale cementimi pa eugenol. Ndiqni udhëzimet e përdorimit të prodhuesve përkatës të cementit.

Paralajmërimet e rrezikut

Mos e thithni me frymëmarrje pluhurin e bluar gjatë përpunimit të "Sagemax PMMA Disc", i cili mund të shkaktojë irritim të syve, lëkurës dhe rrugëve të frymëmarrjes. Prandaj, gjithmonë sigurohuni që nxjerrësi i pajisjes suaj të frezimit të funksionojë në mënyrë të përkryer.

Udhëzime

Nëse dyshohet për intolerancë ndaj produktit, përdoreni atë vetëm pasi të kryhet rpvua e kontrollit për alergji. Dezinfektoni pjesët e frezuara përpara se t'i futni në gojën e pacientit. Këto udhëzime përdorimi bazohen në nivelet aktuale të njohurive rreth produktit. Përdoruesi do të jetë plotësisht përgjegjës për përdorimin e duhur të produktit. Prodhuesi nuk është përgjegjës për rezultatet e pakënaqshme, pasi ai nuk ka kontroll mbi procedurat e përpunimit. Tekniku dentar duhet të informojë dentistin në lidhje me veprimet që duhet të kryhen përpara futjes së restaurimit në gojën e pacientit, duke u siguruar që dentisti të ketë marrë të gjitha informacionet që përmbajnë këto udhëzime përdorimi.

Ruajtja

- Mbrojini materialet nga drita e drejtpërdrejtë e diellit dhe ruajini në një vend të thatë (-18 deri 33°C).
- Respektoni udhëzimet e ruajtjes dhe datën e skadencës në paketimin e jashtëm.
- Shmangni dritën e diellit.
- Mbajeni larg fëmijëve.

sagemax



Prodhuar për:

Sagemax Bioceramics, Inc.

34210 9th Ave. S., Suite 118

Federal Way, WA 98003 USA

Phone: +1 253 214 0389

info@sagemax.com

www.sagemax.com

E	C	R	E	P
---	---	---	---	---

Përfaqësuesi për KE-në:

AB Ardent

Generatorgatan 8

19560 Arlandastad, Sweden

Phone: +46 8594 412 57

info@sagemax.com

www.sagemax.com

C € 0123

RX only

**Vetëm për përdorim
stomatologjik.**

Data: 2019-06-13/Rev.0

SQ

Materiali është krijuar vetëm për përdorim dentar. Përpunimi duhet kryer duke ndjekur me rreptësi Udhëzimet e Përdorimit. Nuk pranohet asnjë përgjegjësi për dëmtime të shkaktuara nga mosrespektimi i udhëzimeve ose mosaplikimi në zonën e duhur. Është përgjegjësi e përdoruesit që ta testojë materialin për përshtatshmëri dhe përdorim për çfarëdo qëllimi tjetër të paspecifikuar në mënyrë të hapur tek udhëzimet. Përkshimet dhe të dhënat nuk ofrojnë ndonjë garanci për vetitë dhe nuk janë detyruese.

© 2019 Sagemax Bioceramics, Inc.